



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

NR	15-020-30953
DATE	15.06.2022
PËR	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal Lipjan
NGA	Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
LËNDA	Kërkesë për procedim për pika të rendit të ditës në Kuvendin e Komunës



Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës ta parasheh në rend të ditës si dy pika të veçanta shqyrtimin - diskutimin e Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2021 dhe Planin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës kombëtare të Kosovës për vitin 2021 të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.

Shtojcë:

1. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2021,
2. Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës kombëtare të Kosovës për vitin 2021 të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPSTINA LIPJAN

LIPJAN MUNICIPALITY

Komuna e Lipjanit
Zyra e Kryetarit

Plani i Zbatimit të rekomandimeve të pranuar me Raportin Final nga Auditori i Zyres kombëtare të Kosovës për vitin 2021 të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit

Baza për Kontrol on	Të Gjeturat në Raportin e ZAP	Rekomandimet	Zyrtari përgjegjës për implementimi në rekomandimit	Aktivitetet e përcaktuara për implementimin e Rekomandimit	Afati kohor i përbushjes
A1	• Në dosjen e tenderit, Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi lumin Sitrnica në Rruc të Ri në vlerë prej 354,549€, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, të kërkesa 5, ndër të tjera është kërkuar dëshmi për Certifikatën ISO 18001 2007. Megjithatë, në dosjen e tenderit nuk kishte	<u>Rekomandimi 1</u> Kryetari duhet të sigurojë kontrole në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës	D. prokurimit	Para nënshkrimit të kontratave të cilat rezultojnë si rekomandim për shpërbim të kontratës pas vlerësimit nga ana e komisionit të vlerësimit Menaxheri i prokurimit, do të sigurohet se vlerësimi është bërë në përputhje me kriteret e	Nga muajin Korrik e tutje

	dëshmi se ekziston kjo certifikatë. Në dosjen e tenderit, Ndërtimi i ndriqimit publik në rrugën Llugaxhi-Gadime, Gadime e Ulët si dhe ndërtimi i trotuarit në rrugën Lipjan-Rrethrotullimi Janjevë në vlerë prej 114,193€, pika III-2.3, është kërkuar që Operatori Ekonomik (OE) duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues për qarkullimin vjetor gjatë tre viteve të fundit 2018-2020, që duhet të jetë jo më pak se 200,000€. Mirëpo në dosjen e tenderit nuk kishte dëshmi për qarkullimin financiar për tre vitet e fundit.	dhe në dosjen e tenderit.			përcaktuara në njoftimin për kontratë.	
A2	Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike, neni 22-procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë.	Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Prokurimi - ZKF	Me qenë kemi identifikuar se ekzistojnë dallime në kohë në mes datës kur Operatori Ekonomik ka pagëdatur faturën dhe datës kur është protokolluar dhe pranuar për pagesë, ne do të angazhohemi që data e urdhërbljes të jetë e njëjtë me datën kur është protokolluar në zyrën e prokurimit.	Nga muajin Korrik e tutje	
A3	Dobësitë e identifikuara në menaxhimin dhe vlerësimin e subvencioneve për mbështetje financiare për klubet sportive janë: Vlerësimi për mbështetje financiare për Klubin Futbollistik Ulpiana në vlerë 14,500€, nuk ishte bërë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. OJQ kishte aplikuar dhe ishin	Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të duhura në mënyrë që vlerësimi i aplikacioneve të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrjet publike, duke mos tejkaluar vlerën e	DRSK -Komisioni i Vlerësimit të ndarjes së Subvencione	Gjate vitit 2022, me rastin e ndarjes se mbështetjeve financiare do të respektohen kriteret për ndarjen e subvencioneve si dhe në momentin kur te i sjellin raportet financiare dhe	Me rastin pranimi te Arsyetimeve nga Qhotat dhe klubet sportive	

aprovuar 6,000€ apo 41% e vlerës së projektit për shpenzimet e pagave dhe mëdijëve për lojtar dhe staf profesional, në kundërshtim me thirrjen publike që ishte e paraparatë 30%⁵. Shpenzimet për mbështetje financiare për Klubin Futbollistik Arbëria, nuk ishin bërë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Për paga të lojtarëve janë aprovuar 6,000€ në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara, mirëpo shpenzimet sipas raportit financiar ishin pranuar nga komuna në vlerë 9,127€ me një tejkalim për 16% apo 3,127€ të shumës së lejuar. Kjo ka ndodh si pasojë e vlerësimit jo profesional dhe jo të drejtë të aplikacionit sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike nga komisioni i vlerësimit dhe monitorimit jo adekuat gjatë implementimit të projektit.	përcaktuar për ndajen e subvencioneve.	ve	narative do të kërkohej arsyetimi të jet në përputhje me përqindjet e lejuara me rasiin e ndarjes së subvencioneve	
A4 Me nenin 39 të LMFP, kërkohej që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Rregullorja MF nr.01/2017 për raportim financiar nga organizatat buxhetore, neni 17, pika 3, parashihet se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri me 31 dhjetor të vitit raportues. Shpallorja e obligimeve të papaguara që kanë kaluar afatin mbi 30 ditë në PFV ishte 162,049€, ku kjo vlerë është mbivlerësuar për 57,284€, pasi që	Rekomandimi 4 Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e mbetura në fundvit të raportohen saktë në PFV, si dhe të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.	Menaxherët e kontratave dhe ZKF	Ne për çdo blerje paraprakisht do të zotojm njetet me qëllim të pagesës së faturave me kohë, në disa raste po paraqiten vonesat në dorëzimin e faturave me kohë nga ana e OE, mirëpo ne si datë të pranimit të faturës e konsiderojmë datën kur fatura është pranuar dhe është protokolluar, gjithashtu me rasiin e përpilimit të P VF, ne do ti përfshijmë në obligimet e papaguara vetëm	Prej Muajit Korrik 2022 dhe me rasiin e përpilimit të P VF për vitin 2022

	kjo vlerë ka të bëjë me detyrim kontingjent dhe jo si faturë e papaguar. Shkaku i mos pagesave brenda afatit ligjor, janë kontrollet e dobëta në menaxhimin e buxhetit dhe hyrja në obligime pa i pasur në dispozicion mjetet e nevojshme.			faturat e pa paguara të cilat mbesin në fund të vitit për muajin dhjetor .	
A5	Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjëse për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas neni 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi. Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishte 673,684€. Borxhi kryesor ishte 449,014€, ndërsa 224,673€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit, këto janë shpenzuar nga: - Kategoria e pagave dhe mëdijëve borxhi kryesor ishte 348,589€, ndërsa shpenzimet shpesh të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit ishin 222,597€; - Kategoria e Investimeve Kapitale borxhi kryesor ishte 100,425€, ndërsa shpenzimet shpesh të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit ishin 2,076€. Kjo ka ndodh si rezultat i mos pagesës me kohë	Rëkomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë, që të ketë fondet e nevojshme për kategorinë e pagave, planifikim të mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shpeshë.	ZKA-ZKF – DBF	Me qëllim të zvogëlim të obligimeve të pa paguara të cilat janë të ndryshme për nga natyra e krijimit të obligimit si : a) Faturat e pranuarra të muajit dhjetor në fillim të vitit dhe faturat e pranuarra për kontrat kornizë për mallrat e po shërbimet para datës së pranimit të ndarjeve të reja buxhetore në fillim të vitit . b) Obligimet të cilat dalin nga kontrata kolektive e nënshtruar nga Qeveria dhe Sindikata pa ndarë një buxhet për OB. Neve na mbetet që të brenda mundësive që kemi të kryejm çdo pagesë me kohë me buxhetin që e kemi , si dhe për obligimet kontingjente të planifikojmë një buxhet për detyrimet kontingjente të pritura .	Në vazhdimësi

	të obligimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë apo pagave përcjellëse, dhe pagesave ndaj furnitorëve, për të cilat nuk kishte pasur buxhet komuna për realizim të pagesave të tilla, si dhe hyrja në obligime pa buxhet.				
B1	Komuna e Lipjanit për vitin 2021 kishte nënshkruar 33 kontrata për punë, shërbime, furnizime, të cilat nuk ishin pjesë e planifikimit të prokurimit. Për këto Komuna nuk kishte dërguar në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondave së pakut pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. Nuk janë dërguar njoftimet në AQP me arsyetimin e mungesës së stafit (reduktimi i stafit) të krijuar nga situata pandemike me Covid-19.	Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë se do të marrë masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivite të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.	D. Prokurimit	Neve vetëm kemi filluar zbatimin e këtij rekomandimi, për të gjitha aktivitetet e prokurimit të cilat nuk janë të përfshira në planin e prokurimit për vitin 2022, të dorëzuar në AQP.	Është duke u zbatuar
B2	Rregulloria 04/2017-Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës. Komuna edhe pse me Buxhet të Kosovës kishte paraparë që gjatë vitit	Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Planit Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, Raporti	DRSK-	Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare për vitin 2022, është dërguar për publikim në faqen e Komunes dhe në Zyren e Kryeministrit, ndërsa për vitin 2021, është dërguar Gjithpërfshirës Vjetor i mbështetje financiare publike për OJQ,	Rekomandimi është zbatuar

	2021 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQvë, megjithatë nuk ka përmbyshur kërkesën ligjore për përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare. Mungesa e llogaridhënies në nivelin e duhur nga menaxhmenti për menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve ka ndikuar në mos përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare.	Gjithëpërfshirës Vjetor i mbështetje financiare publike për OJQ, si dhe të dhënat që përshihen në plan të korrespondojnë me Buxhejin e Miratuar.			
A6	Ligji Nr. 07/L-001 për Buxhejin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe Ligji Nr. 07/L-014 për rishikimin e buxhetit 2021, si dhe plani kontabël përcaktojnë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuatë ekonomike. Gjithashtu U.A Nr. 19/2009 për planin kontabël, neni 8.1 ka përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike. Në tre mostrat e testuara nga kategoria investimeve kapitale në vlerë totale 8,042€, kemi identifikuar se shpenzimet e paguara nga kategoria e Investimeve Kapitale, janë bërë për pajisje nën 1,000€, përderisa i takojnë kategorisë Mallra dhe Shërbime. Ndërsa vlera 48,000€ është paguar nga kategoria për Subvencione dhe Transfere përmes thesarit, përderisa janë investime mbi 1,000€, që i takojnë kategorisë Investime Kapitale. Keqklasifikimi ka ndodh për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.	Rekomandimi 8 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuatë të buxhetit (apo të ridentifinohen mjetet kur është e nevojshme dhe që mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuatë.	ZKF – Zyrtarët Autorizues dhe zyrtarët zotues të mjeteve	Zyrtari Financiar do të kërkoj që zyrtarët autorizues dhe ata zotues në rastet kur kanë detyrime lidhur me përdorimin e nënkodeve ekonomike sipas kategorisë me planin kontabël do të sugjeroj që të përdorin kodet adekuatë me qëllim të evitimit të keqë –klasifikimit	Prej Muajit Korrik 2022
	Përgatitja e PFV-e duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të				

Op

A7	Kontabiliteti të Sektorit Publik dhe Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr.01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatës buxhetore. Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PFV-të sipas afatit të paraparë deri me 30 janar. Megjithatë me rasiin e rishikimit të PFV-e, nga ana e auditimit, janë vërejt disa çështje të cilat i kemi rekomanduar Çështjet e identifikuara janë: Te neni 13 - Pasqyra e pranimave dhe pagesave burimi i fondeve - te pjesa pranimit tjera nuk ishin prezantuar kithimi nga donacionet në vlerë 148,708.30€; Te neni 13 - Pasqyra e pranimave shfrytëzimi i fondeve - shënimi nr. 7 pagesa tjera të prezantohet kithimi i donacioneve ne vlerë prej 148,708.30€ si dalje e parase; Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit te buxheut pjesa hyrja e parase në LLVTH te shënimi 9 të hyra jotatimore te Buxheti fillestar dhe Buxheti final është paraqit vlera gabim me vlerë të përfaqët 854,000€ përderisa buxheti fillestar dhe final sipas ligjit të buxheut për të hyrat jotatimore është 1.004,005€; Te neni 14, Raportimi i ekzekutimit të buxheut-hyrja e parase së gatshme tjera shënimi 12 tek realizimi i te hyrave nuk është paraqitur të hyrat nga viti i kaluar Kodi Ekonomik 61000 ne vlerë 1.000€. Me rekomandim ato janë korigjuar me datë	Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, që gjatë hartimit të PFV-e për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga ZKA dhe ZKF të nënskruhen vetëm pasi që të janë siguruar që PFV janë të sakta dhe plotë.	ZKF –sektori i buxhetit	Me rasiin e përpilimit të Pasqyrave vjeore Financiare për vitin 2022 , para se të dorëzohen PVF , do të rishikohen edhe njëherë me qëllim të evitimit të gabimeve dhe mos përfshirjes së zërave të caktuar dhe mos paraqitjes së shumave të pasakta me gabime teknike	Me rasiin e përpilimit të Pasqyrave Vjetore për vitin 2022
----	---	--	---------------------------------------	--	---

CP

28.02.2022, mirëpo pas korigjimit kishin ndodh dy gabime teknike: Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit te buxheut pjesa hyrja e parase në LLVTH te shënimi 9-të hyra jotatimore te pjesa, A-Realizimi është paraqit vlera gabim me 751,111€, përderisa duhet të jetë 1,049,187€, është nënvlerësuar për 298,075€ (gabimisht të hyrave jotatimore i është zbrit vlera e të hyrave indirekte edhe pse ato nuk kanë qenë të përfshira tek të hyrat jotatimore). Kjo vlerë te shënimi 9 të hyrat jo tatimore është paraqit vlera e saktë. Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit te buxheut pjesa hyrja e parase në LLVTH te shënimi 11-grantet e përcaktuara të donatorëve, te pjesa A-Realizimi është paraqit vlera gabim me 498,155€, përderisa duhet të jetë 349,447€, është mbivlerësuar për 148,708€ (gabimisht kthimi i donacioneve i është shtuar vlerës së donacionit). Me rekomandim ato janë korigjuar me datë 31.03.2022.				
---	--	--	--	--

CM

A8	Rregullorja Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 4 parimet e përgjithshme, potencon se Financimi i OJQ-ve nga ofruesit e mbështetjes financiare bëhet duke u bazuar në kriteret e caktuara më parë të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioritetve të mbështetjes financiare. Në thirrjen për aplikim për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë nr. 12-320-23890 të datës 17.05.2021 është kërkuar që aplikuesit duhet të dorëzojnë Fletëposedimin për patundshmëri në emër të aplikuesit ose të ndonjë anëtarit të familjes, mirëpo nuk ishte specifikuar në kriteret^e kërkesave për dokumentacion se cila prej dëshmive do të vënte konte se fletë poseduese është në emër të ndonjërit prej familjarëve të përfuturit, për rastet kur fletë poseduese nuk është në emër të përfuturit. Komuna kishhte vlerësuar se kriteret e vendosura në thirrjen publike për mbështetjen financiare të fermerëve ishin të mjaftueshme.	Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara në thirrjet publike për mbështetje financiare të jenë të duhura në mënyrë që dokumentacioni i përcaktuar me kriteret siguron dëshmi të mjaftueshme për verifikimin e të dhënave të dorëzuara nga aplikuesit.	Drejtorja e Bujqësisë	Me rasiin e ndarjes së subvencioneve për serra , në kuadër të kriterëve të cilat do të publikohen , me qëllimin të dokumentimit të saktë të procesit , do të kërkohet që në rastet kur aplikojn familjarët me fletë poseduese të ndonjë familjari të kërkohet edhe certifikata familjare .	Me rasiin e ndarjes së subvencioneve në vitin 2022
A9	Sipas rregullores për plotësim ndryshimin e rregullores për studentët e Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 të datës 29.05.2020 nenit 9, kriteret për përfitim të bursës, pika 1.7 përcakton se studentit/ja me studime në drejtime deficitare të vlerësohen me 10 pikë (drejtimet deficitare që mund	Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara në konkurse të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme.	DKA – komisioni për	Rregullorja për ndarjen e bursave është përpiluar dhe është aprovuar në asambleë Komunale dhe e njëjta përcakton mënyrën se si do të implementohen drejtimit deficitare	Gjatë këtij viti ,me rasiin e ndarjes së bursave (nëntor – dhjetor 2022)

CM

t'iu jepet përparësi të përcaktohen në thirrjen publike për aplikim nga Drejtoria për Arsime). Ne kemi identifikuar se në konkursin Nr.4-111-64445 të datës 19.10.2021 për ndarjen e bursave për student të komunës së Lipjanit, nuk ishte vendos kriteri për vlerësimin me 10 pikë për drejtime deficitare. Si pasojë e mosvendosjes së kriterit në konkurs, për pikët për kuadro deficitare, studentit (me numër të protokollit të dorëzuar 66099, të datës 26.10.2021) i kuadrit deficitar ishte eliminuar nga përfitim i bursës.		përpilimin rregulloreve		
B3 Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, cion që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave. Rritja e të arkëtueshmeve ndaj komunës, në fund të vitit 2021 ishin prej 409,292 € ose 8.4% më tepër se në vitin 2020. Sfida kryesore mbetet në inkasimin e tatimit në pronë, e cila është rritur për 10% në vitin 2021. Përkundër faktit se komuna ka marr masa lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme tek tatimi në pronë duke dërguar vërejtje dhe njoftimet përfundimtare tek tatimpaguesit, rritja e tyre vazhdon nga viti në vit. Kjo rritje ishte e ndikuar edhe nga borxhet e ndërmarrjeve	Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afaniste.	DBF-sektori i buxhetit - Zyra ligjore -ZKA	ZTP me qëllim të përmbytjes së rekomandimit për inkasimin e borxheve të pa paguara , po ndermerr , dhe do ti ndermerr të gjitha këto aktivite: a) Kemi përpiluar regjistr të të gjithë tatimpaguesia të cilat kanë vlerë të madhe të obligimeve të pa paguara. b) Po ashtu jemi bashkëpunues dhe do të vazhdojme të gjitha komunikimet me AKP që në rastin e privatizimit të Ndermarrjeve Shogërore tu përcjellim faturat për pagesë.	Prej Muajt Korrik 2022

067


shoqërore të privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimiti në vlerë prej 710,643 €. Po ashtu, borxhet nga taksat per ushtrimin e veprimtarisë janë mjaft të larta dhe të përcjellura që nga viti 2013 në vlerë 578,359€. Kjo ndodh për arsye të mos vendosjes së mekanizmave adekuat në kohën e duhur nga ana e Komunës për arkitimin e borxheve.				-Drejtoriati për Ekonomi dhe Zhvillim ka dërguar në Zyrën e Kryetarit të Komunës listën e bizneseve që kanë borxhe për ushtrimin e veprimtarisë të cilat janë përcjellur që nga viti 2013 dhe është propozuar nga Drejtoriati për Ekonomi dhe Zhvillim që të dërgohen për rishqyrtimin e tyre në Kuvendin Komuna për mundësinë e faljes - shlyerjes së borjeve dhe pritjet që në një nga seancat e radhës të Kuvendit të Komunës të shqyrtohet kjo çështje.	Planifikohet të diskutohet në njërin nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Komunës të sjashtë Mujori të dytë të vitit 2022.
---	--	--	--	---	---

Plani i zbatimit u kompletuar nga NJAB –Lipjan

Kordinatori: Visar Kozhani


Miratoi : Kryetari i Komunës

Z. Imri Ahmeti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit (KL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Lipjanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm;
- B1 Komuna ka zhvilluar procedura të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak të AQP-së;
- A2 Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërbljes;
- A3 Mangësi në vlerësimin dhe pagesën e subvencioneve për klubet sportive;
- A4 Mospagesa e faturave brenda afatit ligjor dhe mbivlerësim i obligimeve të papaguara;
- A5 Shpenzime për procedurat përmbartimore;
- B2 Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve.

Më gjerësisht shih nëkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Lipjanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Lipjanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Lipjanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Lipjanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjisllacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Lipjanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Dobësitë e identifikuara janë në fushat si: të hyrat, mangësi në vlerësimin e tenderëve, menaxhimi i subvencioneve, të arkëtueshmet, obligimet e papaguara, përfshirë edhe kontrollet e brendshme të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PFV-të të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre nëntë (9) janë rekomandime të reja dhe tre (3) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm

Gjetja

Bazuar në LPP, neni 59.4, përcakton se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

- Në dosjen e tenderit, Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica në Rufc të Ri në vlerë prej 354,549€, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, te kërkesa 5, ndër të tjera është kërkuar dëshmi për Certifikatën ISO 18001 2007. Megjithatë, në dosjen e tenderit nuk kishte dëshmi se ekziston kjo certifikatë.
- Në dosjen e tenderit, Ndërtimi i ndriqimit publik në rrugën Llugaxhi-Gadime, Gadime e Ulët si dhe ndërtimi i trotuarit në rrugën Lipjan-Rrethrotullimi Janjevë në vlerë prej 114,193€, pika III-2.3, është kërkuar që Operatori Ekonomik (OE) duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues për qarkullimin vjetor gjatë tre viteve të fundit 2018-2020, që duhet të jetë jo më pak se 200,000€. Mirëpo në dosjen e tenderit nuk kishte dëshmi për qarkullimin financiar për tre vitet e fundit.

Ndikimi

Përzgjedhja e OE fitues që nuk përmbush kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit, rezulton me shpërblimin e OE në kundërshtim me kërkesat ligjore. Kjo mund të rrezikojë cilësinë e shërbimeve dhe arrijen e objektivave të parapara në projekt.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë kontrolle në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërblërjes

Gjetja

Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike, neni 22-procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë.

Në katër raste për mallra dhe shërbime në vlerë prej 72,581€ kemi identifikuar se ishin pranuar faturat para procesimit të urdhërblërjeve.⁴

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi	Mosfunksionimi i sistemit të kontrolleve duke pranuar shërbime para krijimit të urdhërblërjes, mund të rezultojë me vonesa të pagesave të faturave.
Rekomandimi A2	Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në vlerësimin dhe pagesën e subvencioneve për klubet sportive

Gjetja	Sipas thirrjes publike për OJQ numër 1-453-17339 të datës 31.03.2021 pika 2f për projektet që kontribuojnë në avancimin, afirmimin dhe zbulimin e talenteve të rinjë në sport në komunën e Lipjanit, në thirrje mund të aplikojnë me projekte në lëmin e sportit dhe sipas shpenzimeve të pranuar drejtpërdrejt pagesat deri në 30% nga shuma e subvencionuar për paga dhe mëditje për lojtar dhe staf tjetër profesional.
---------------	--

Dobësitë e identifikuar në menaxhimin dhe vlerësimin e subvencioneve për mbështetje financiare për klubet sportive janë:

- Vlerësimi për mbështetje financiare për Klubin Futbollistik Ulpiana në vlerë 14,500€, nuk ishte bërë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. OJQ kishte aplikuar dhe ishin aprovuar 6,000€ apo 41% e vlerës së projektit për shpenzimet e pagave dhe mëditjeve për lojtar dhe staf profesional, në kundërshtim me thirrjen publike që ishte e paraparë 30%⁵.
- Shpenzimet për mbështetje financiare për Klubin Futbollistik Arbëria, nuk ishin bërë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Për paga të lojtarëve janë aprovuar 6,000€ në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara, mirëpo shpenzimet sipas raportit financiar ishin pranuar nga komuna në vlerë 9,127€ me një tejkalim për 16% apo 3,127€ të shumës së lejuar.

Kjo ka ndodh si pasojë e vlerësimit jo profesional dhe jo të drejtë të aplikacionit sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike nga komisioni i vlerësimit dhe monitorimit jo adekuat gjatë implementimit të projektit.

Ndikimi	Monitorimi dhe vlerësimi jo drejtë i subvencioneve ndikon në përzgjedhjen e përfituesve që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike dhe në cilësinë e implementimit të projektit, apo në mosarritjen e objektivave për të cilat janë aprovuar subvencionet.
Rekomandimi A3	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të duhura në mënyrë që vlerësimi i aplikacioneve të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrjet publike, duke mos tejkaluar vlerën e përcaktuar për ndarjen e subvencioneve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos pagesa e faturave brenda afatit 30 ditë dhe raportimi jo i drejtë

Gjetja Me nenin 39 të LMFPF, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Rregullorja MF nr.01/2017 për raportim financiar nga organizatat buxhetore, neni 17, pika 3, parasheh se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri me 31 dhjetor të vitit raportues.

Shpalosja e obligimeve të papaguara që kanë kaluar afatin mbi 30 ditë në PFV ishte 162,049€, ku kjo vlerë është mbivlerësuar për 57,284€, pasi që kjo vlerë ka të bëjë me detyrim kontigjent dhe jo si faturë e papaguar.

Shkaku i mos pagesave brenda afatit ligjor, janë kontrollet e dobëta në menaxhimin e buxhetit dhe hyrja në obligime pa i pasur në dispozicion mjetet e nevojshme.

Ndikimi Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor rritë mundësinë që furnitorët të drejtohen përmbauesve dhe gjykatave ku krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunës. Përderisa raportimi i mangët i obligimeve ndikon në saktësinë e shpalosjes së PFV-ve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e mbetura në fundvit të raportohen saktë në PFV, si dhe të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Shpenzime për procedurat përmbaimore**

Gjetja Neni 39 i LMFPF, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbauesi.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbaimore ishte 673,684€. Borxhi kryesor ishte 449,014€, ndërsa 224,673€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbaimit, këto janë shpenzuar nga:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve borxhi kryesor ishte 348,589€, ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbaimit ishin 222,597€;
- Kategoria e Investimeve Kapitale borxhi kryesor ishte 100,425€, ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbaimit ishin 2,076€.

Kjo ka ndodh si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë apo pagave përcjellëse, dhe pagesave ndaj furnitorëve, për të cilat nuk kishte pasur buxhet komuna për realizim të pagesave të tilla. si dhe hvria në obligime pa buxhet.

Ndikimi Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë, që të ketë fondet e nevojshme për kategorinë e pagave, planifikim të mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Zhvillimi i procedurave të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak në AQP

Gjetja Ligji i prokurimit publik, neni 9, pika 6, përcakton se nëse objektet e aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit kontraktues i cili është dorëzuar në AQP sipas paragrafit 2. të nenit 8 të këtij ligji, ZKA do të dërgojë në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. AQP -ja do të shqyrtojë çdo deklaratë të nevojave për të përcaktuar se nëse ka ndonjë metodë tjetër më efikase dhe më ekonomike për blerjen e mallrave të tilla ose produkteve të tjera, që i plotësojnë nevojat e autoritetit kontraktues.

Komuna e Lipjanit për vitin 2021 kishte nënshkruar 33 kontrata për punë, shërbime, furnizime, të cilat nuk ishin pjesë e planifikimit të prokurimit. Për këto Komuna nuk kishte dërguar në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit.

Nuk janë dërguar njoftimet në AQP me arsyetimin e mungesës së stafit (reduktimi i stafit) të krijuar nga situata pandemike me Covid-19.

Ndikimi Tenderimet jashtë planit të prokurimit pasqyrojnë mungesë të vlerësimit të nevojave dhe planifikim të dobët të kërkesave. Përderisa mosnjoftimi i AQP-së mund të ndikojnë në pamundësi të shqyrtimit të AQP-së për aplikim të metodave tjera më efikase dhe më ekonomike për blerjen e mallrave të tilla ose produkteve të tjera, që i plotësojnë nevojat e autoritetit kontraktues.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve

Gjetja	Rregullorja 04/2017-Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës. Komuna edhe pse me Buxhet të Kosovës kishte paraparë që gjatë vitit 2021 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, megjithatë nuk ka përmbushur kërkesën ligjore për përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare.
	Mungesa e llogaridhënies në nivelin e duhur nga menaxhmenti për menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve ka ndikuar në mos përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare.
Ndikimi	Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave se cilat fusha do përkrahën nga Komuna, si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete.
Rekomandimi B2	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, Raporti Gjithëpërfshirës Vjetor i mbështetjes financiare publike për OJQ, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar.
Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)	

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A6 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Ligji Nr. 07/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe Ligji Nr. 07/L-014 për rishikimin e buxhetit 2021, si dhe plani kontabël përcaktojnë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuatë ekonomike. Gjithashtu UA Nr. 19/2009 për planin kontabël, neni 8.1 ka përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

Në tre mostrat e testuara nga kategoria investimeve kapitale në vlerë totale 8,042€, kemi identifikuar se shpenzimet e paguara nga kategoria e Investimeve Kapitale, janë bërë për pajisje nën 1,000€, përderisa i takojnë kategorisë Mallra dhe Shërbime.

Ndërsa vlera 48,000€ është paguar nga kategoria për Subvencione dhe Transfere përmes thesarit, përderisa janë investime mbi 1,000€, që i takojnë kategorisë Investime Kapitale.

Keqklasifikimi ka ndodh për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

Ndikimi Klasifikimet ekonomike jo të sakta prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuatë të buxhetit (apo të ridestinojnë mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuatë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mungesa e kontrolleve në përgatitjen e Draft Pasqyrave Financiare Vjetore

Gjetja Përgatitja e PFV-e duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr.01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatës buxhetore.

Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PFV-të sipas afatit të paraparë deri me 30 janar. Megjithatë me rastin e rishikimit të PFV-e, nga ana e auditimit, janë vërejt disa çështje të cilat i kemi rekomanduar

Komunës për korigjim.

Çështjet e identifikuara janë:

Te neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave burimi i fondeve - te pjesa pranimet tjera nuk ishin prezantuar kthimi nga donacionet në vlerë 148,708.30€;

Te neni 13 - Pasqyra e pranimeve shfrytëzimi i fondeve - shënimi nr. 7 pagesa tjera të prezantohet kthimi i donacioneve ne vlerë prej 148,708.30€ si dalje e parasë;

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit te buxhetit pjesa hyrja e parasë në LLVTH te shënimi 9 të hyra jotatimore te Buxheti fillestar dhe Buxheti final është paraqit vlera gabim me vlerë të përafërt 854,000€ përderisa buxheti fillestar dhe final sipas ligjit të buxhetit për të hyrat jotatimore është 1,004,005€;

Te neni 14, Raportimi i ekzekutimit të buxhetit-hyrja e parasë së gatshme-tjera shënimi 12 tek realizimi i te hyrave nuk është paraqitur të hyrat nga viti i kaluar Kodi Ekonomik 61000 ne vlerë 1,000€.

Me rekomandim ato janë korigjuar me datë 28.02.2022, mirëpo pas korigjimit kishin ndodh dy gabime teknike:

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit te buxhetit pjesa hyrja e parasë në LLVTH te shënimi 9-të hyra jotatimore te pjesa, A-Realizimi është paraqit vlera gabim me 751,111€, përderisa duhet të jetë 1,049,187€, është nënvlerësuar për 298,075€ (gabimisht të hyrave jotatimore i është zbrit vlera e të hyrave indirekte edhe pse ato nuk kanë qenë të përfshira tek të hyrat jotatimore). Kjo vlerë te shënimi 9 të hyrat jo tatimore është paraqit vlera e saktë.

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit te buxhetit pjesa hyrja e parasë në LLVTH te shënimi 11-grantet e përcaktuara të donatorëve, te pjesa A-Realizimi është paraqit vlera gabim me 498,155€, përderisa duhet të jetë 349,447€, është mbivlerësuar për 148,708€ (gabimisht kthimi i donacioneve i është shtuar vlerës së donacionit).

Me rekomandim ato janë korigjuar me datë 31.03.2022.

Kjo kishte ndodh për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme dhe kujdesit të mangët të stafit përgjegjës në përgatitjen e PFV-ve.

Ndikimi

Paraqitja jo e drejtë dhe e saktë e të dhënave në PVF, jep një pasqyrim jo të plotë për shfrytëzuesit e PVF-ve. Si pasojë, referuar në PFV, kjo mund të ndikojë edhe në marrjen e vendimeve të gabuara nga vetë Komuna apo shfrytëzuesit e sajë.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, që gjatë hartimit të PFV-e për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga ZKA dhe ZKF të nënshkruhen vetëm pasi që të janë siguruar që PFV janë të sakta dhe të plota.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 603,143€, prej prej të cilave ishin shpenzuar 445,909€ apo 74%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionet për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, për kulturë rini dhe sport, shëndetësi dhe përkujdesje sociale etj.

Çështja A8 - Kriteret për ndarjen e serave nuk ishin mjaftueshëm të verifikueshme për fletën poseduese të patundshmërisë

Gjetja Rregullorja Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 4 parimet e përgjithshme, potencon se Financimi i OJQ-ve nga ofruesit e mbështetjes financiare bëhet duke u bazuar në kriteret e caktuara më parë të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioritetëve të mbështetjes financiare.

Në thirrjen për aplikim për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë nr. 12-320-23890 të datës 17.05.2021 është kërkuar që aplikuesit duhet të dorëzojnë Fletëposedimin për patundshmëri në emër të aplikuesit ose të ndonjë anëtarit të familjes, mirëpo nuk ishte specifikuar në kriteret e kërkesave për dokumentacion se cila prej dëshmimeve do të vërtetonte se fleta poseduese është në emër të ndonjërit prej familjareve të përfituesit, për rastet kur fleta poseduese nuk është në emër të përfituesit.

Komuna kishte vlerësuar se kriteret e vendosura në thirrjen publike për mbështetjen financiare të fermerëve ishin të mjaftueshme.

Ndikimi Mos specifikimi në thirrjen publike se cili dokument mbështetës e plotëson kriterin që fleta poseduese e patundshmërisë është në emër të familjarëve të përfituesve, mund të rezultojë në përzgjedhje jo të drejtë të përfituesve.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara në thirrjet publike për mbështetje financiare të jenë të duhura në mënyrë që dokumentacioni i përcaktuar me kriteret siguron dëshmi të mjaftueshme për verifikimin e të dhënave të dorëzuara nga aplikuesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Kriteret në konkurs nuk ishin në harmoni të plotë me rregulloren për ndarjen e bursave.

Gjetja Sipas rregullores për plotësim ndryshimin e rregullores për studentët e Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 të datës 29.05.2020 nenit 9, kriteret për përfitimin e bursës, pika 1.7 përcakton se studenti/ja me studime në drejtime deficitare të vlerësohen me 10 pikë (drejtimet deficitare që mund t'iu jepet përparësi të përcaktohen në thirrjen publike për aplikim nga Drejtoria për Arsim).

Ne kemi identifikuar se në konkursin Nr.4-111-64445 të datës 19.10.2021 për ndarjen e bursave për student të komunës së Lipjanit, nuk ishte vendos kriteri për vlerësimin me 10 pikë për drejtime deficitare. Si pasojë e mosvendosjes së kriterit në konkurs, për pikët për kuadro deficitare, studenti (me numër të protokollit të dorëzuar 66099, të datës 26.10.2021) i kuadrit deficitar ishte eliminuar nga përfitimi i bursës.

Drejtoria për Arsim e Komunës së Lipjanit nuk kishte vlerësuar të nevojshme vendosjen e kriterit për drejtime deficitare për ndarjen e bursave të komunës.

Ndikimi Mos vendosja e kriterit për vlerësimin e 10 pikëve për drejtimet deficitare ka ndikuar në eliminimin e studentëve të kuadrit deficitar.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara në konkurse të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Vlera e shpalosur në PFV ishte 5,267,819€ me një rritje prej 409,292€ krahasuar me vitin 2020. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, shpronësimi dhe shfrytëzimi i pronës publike.

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Rritja e të arkëtueshmeve ndaj komunës, në fund të vitit 2021 ishin prej 409,292 € ose 8.4% më tepër se në vitin 2020.

Sfida kryesore mbetet në inkasimin e tatimit në pronë, e cila është rritur për 10% në vitin 2021. Përkundër faktit se komuna ka marr masa lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme tek tatimi në pronë duke dërguar vërejtje dhe njoftimet përfundimtare tek tatimpaguesit, rritja e tyre vazhdon nga viti në vit. Kjo rritje ishte e ndikuar edhe nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në vlerë prej 710,643 €. Po ashtu, borxhet nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë janë mjaft të larta dhe të përcjellura që nga viti 2013 në vlerë 578,359€.

Kjo ndodh për arsye të mos vendosjes së mekanizmave adekuat në kohën e duhur nga ana e Komunës për arkëtimin e borxheve.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me refleksion negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afariste.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	16,719,155	18,532,860	17,808,414	17,751,726	15,620,345
Grante Qeveritare - Buxheti	14,811,839	15,258,818	15,027,299	15,498,441	13,294,779
Financimi përmes huamarrjes	0	70,050	69,971	144,330	52,756
Të bartura nga viti i kaluar	0	930,196	665,239	634,753	726,878
Të hyrat vetanake	1,907,316	1,907,316	1,690,784	1,179,471	1,428,423
Donacionet vendore	0	41,520	34,001	973	0
Donacionet e jashtme	0	324,960	321,119	293,758	117,508

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,813,705€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura 930,195€, donacionet e jashtme dhe të brendshme 366,480€, financimi nga huamarrja 70,050€ dhe ndryshimet me vendim të Qeverisë me një rritje për 446,980€.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar, me një rritje të shpenzimit me 7% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Shpenzimet gjatë vitit 2021 për rimëkëmbje ekonomike ishin 370,891€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me kompensimin e pagave shtesë të zjarrfikësve, punëtorëve shëndetësor dhe të arsimit, sipas vendimeve të nivelit qendror.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,719,155	18,532,860	17,808,414	17,751,726	15,620,345
Pagat dhe mëditjet	9,574,000	10,080,734	10,075,472	9,574,292	9,096,502
Mallrat dhe shërbimet	1,700,000	1,790,254	1,742,262	2,538,030	1,369,749
Komunalitë	280,000	308,027	266,640	210,479	231,793
Subvencionet dhe transferet	500,000	603,143	445,909	592,738	400,221
Investimet Kapitale	4,530,155	5,750,703	5,278,131	4,836,186	4,522,080
Rezervat	135,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 506,734€. Rritja kishte ndodhur nga huamarrja 40,645€ për programin e rimëkëmbjes ekonomike, nga grantet e donatorëve të brendshëm dhe jashtëm 38,860€, si dhe nga buxheti për zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike 427,229€ për paga dhe shtesa në shëndetësi, arsim, zjarrëfikësat, si dhe mbulesa e pagave në fundvit;
 - Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 90,253€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura 72,053€ me vendim të Kuvendit Komunal, nga huamarrja 16,530€, nga grantet e donatorëve të brendshëm dhe jashtëm 1,920€, si dhe zvogëlim nga buxheti 250€;
 - Buxheti për shërbimet komunale ishte rritur nga të hyrat e bartura për 28,027€;
 - Buxheti për subvencione ishte rritur për 103,143€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura 33,143€ me vendim të Kuvendit Komunal si dhe 70,000€ me vendim të Qeverisë për subvencionim për dëmet dhe vërshimet;
 - Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,220,548€. Rritja kishte ndodhur nga rezervat 135,000€, nga të hyrat e bartura 796,973€ me vendim të Kuvendit Komunal, nga huamarrja 12,875€, nga grantet e donatorëve të brendshëm dhe jashtëm 325,700€, si dhe zvogëlim nga buxheti 50,000€ me vendim të Qeverisë;
- Buxheti final për investime kapitale ishte shpenzuar 92%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Lipjanit në 2021 ishin 2,128,66€, me një rritje prej 33% krahasuar me vitin paraprak. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës, si në vijim: gjobat në trafik 249,102€, gjobat nga gjykatat 47,690€ dhe të hyra nga pyjet 1,284€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,907,316	1,907,316	2,128,666	1,550,680	1,888,072
Të hyrat tatimore	903,311	903,311	1,078,479	761,366	917,688
Të hyrat jo tatimore	1,004,005	1,004,005	1,049,187	789,314	970,385
Të hyrat tjera	0	0	1,000		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Në Kuvendin Komunal ishte shqyrtuar raporti i ZKA-së, për PFV-të e vitit 2020. Deri në fund të auditimit për vitin 2021, katër (4) rekomandime janë zbatuar dhe tre (3) rekomandime janë të përsëritura, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.	Komuna edhe këtë vit ka vazhduar me aktivitete jashtë planit të prokurimit pa njoftim paraprak në AQP.	Nuk është adresuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe shpenzimet e Komunës janë bërë konform qëllimit për të cilin janë alokuar dhe vendimeve të Qeverisë.	Nuk janë evidentuar pagesa të tilla.	I zbatuar

3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit nga komisionet e vlerësimit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë.	Nuk janë evidentuar raste të tilla të kategorisë e mallrave dhe shërbimeve. Megjithatë, raste të njëjta janë evidentuar të kategorisë e investimeve kapitale, ku janë trajtuar si çështje.	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, Raporti Gjithëpërfshirës Vjetor i mbështetje financiare publike për OJQ, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar.	Komuna akoma nuk ka plan vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve.	Nuk është adresuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, dhe nëse përfituesit e subvencionuar në raportimin e tyre nuk arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas kontratës, të zbatohen masat e përcaktuara me kontratë.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se plani dinamik për përfundimin e punëve është respektuar nga OE, si dhe siguria e ekzekutimit do të mbetet valide për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës në mënyrë që t'i ikë rrezikut për shpenzimet shtesë në rast të vonësive në punë dhe dëmeve tjera.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afariste.	Komuna akoma nuk ka arrit të ulë vlerën e Llogarive të Arkëtueshme.	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit




Selvete Foniqi, Udhëheqëse e ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Bahri Statovci, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me Prillogje:	10.05.2022	
Njësia Jednice:	Nutri Bosj	Shtojca Dodatak
1-470/04-	23462	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Fushë Kosovës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit

Data: 10.05.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore Fatura numer 03/21 në shumë 15,000€ ishte pranuar me datën 26.02.2021 ndërsa urdhërblerja ishte proceduar me datën 15.03.2021 shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, 1 012,00 €, Fatura numer 03/2021 ishte pranuar me datën 02.12.2021 ndërsa urdhërblerja ishte proceduar me datën 03.12.2021 Mirëmbajtja e varrezave në komunën e Lipijanit, 26 225,55 €, Fatura numer 29/21 ishte pranuar me datën 03.09.2021 ndërsa urdhërblerja ishte proceduar me datën 09.09.2021 Mirëmbajtja & pastrimi i rrugëve gjatë sezonit dimror Loti 3 Via Ignatia 30 344,12 €, Fatura numer 08/201 në shumë 30,344€ ishte pranuar me datën 21.05.2021 ndërsa urdhërblerja ishte proceduar me datën 20.08.2021
- ⁵ Vlera totale e subvencionuar për klubin futbollistik ishte 14,500€, ku për shpenzimet e pagave janë aprovuar $14,500€ \cdot 41.38\% = 6,000€$, përderisa do duhej të aprovohej $14,500€ \cdot 30\% = 4,350€$.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.